



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Tiranë, Korrik 2015

RAPORT *(Përfundimtar)*

Për inspektimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në zbatim të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*, ka realizuar inspektimin e përgjithshëm në lidhje me mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar është person juridik, buxhetor, shtetëror, në varësi të Kryeministrit. Është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.01.2004, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit nr. 8457, datë 29.01.2004 *“Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”*”. Struktura dhe Organika e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar miratohen nga Kryeministri.

Inspektimi i përgjithshëm është programuar dhe ka për qëllim të verifikojë zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, për disa institute të tij që kanë të bëjnë me procesin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, hartimin e përkrahjes të punës për pozicione që janë pjesë e shërbimit civil, në përputhje me procedurat, formatin e miratuar dhe legjislacionin specifik të fushës, me dokumentimin e procesit të verifikimit të procedurave të rekrutimit për secilin punonjës të institucionit, si dhe me verifikimin e arsyeve të moszekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas programit të inspektimit nr. 245/2 prot., datë 11.03.2015, *“Për kryerjen e inspektimit në lidhje me disa aspekte të administrimit në shërbimin civil”*, nga data 20.03.2015, i cili i është njoftuar fillimisht institucionit me shkresën nr. 245/1 prot., datë 11.03.2015, *“Njoftim mbi fillimin e*

verifikimit të shkresës dhe kërkim dokumentacioni” dhe me shkresën nr. 245/3, dt. 18.03.2015 “Njoftim për shtyrjen e datës së fillimit të inspektimit”.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, grupi i inspektimit, i përbërë nga inspektorët Matilda Idrizaj dhe Ledina Zhupa, në drejtimin teknik të Drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Ilia Kukumi, ka bërë përpunimin e të dhënave dhe ka përgatitur projektraportin e inspektimit për këtë institucion, të cilin ia ka dërguar për njohje institucionit, me shkresën nr. 245/8, datë 14.05.2015, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Pas kësaj, projektraporti është nënshkruar pa vërejtje nga Drejtori i DSIK, ***** , ndërsa Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, ***** , është shprehur se nuk është dakord me projektraportin.

Në lidhje me projektraportin, nga DSIK janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 1581 Prot., datë 20.05.2015 dhe dokumentacionet provuese të observacioneve.

Për efekt të verifikimit të pretendimeve të ngritura në observacionet lidhur me projektraportin nga ana e DSIK dhe në kuadër të plotësimit të procesit të inspektimit pranë këtij institucioni, grupi i inspektimit u paraqit në Institucion më datë 01.06.2015 për t’u njohur me dokumentacionin e cituar në observacion.

Qëllimi i inspektimit

Qëllimi i realizimit të inspektimit është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për nëpunësit civil në këtë institucion.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Objekti i inspektimit:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, dt.11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil.
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.

4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil.
5. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm të disiplinës).
6. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, referuar Kreut XII "*Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil*", të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe çfarë masash organizative janë marrë për zbatimin e vendimeve gjyqësore, për kthimin e punonjësve në vendin e mëparshëm të punës, nëse ka të tilla.
7. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Metodologjia e inspektimit:

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në subjekt të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e financës, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të inspektimit, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim në formën e bashkëbisedimit me titullarin, ***** , titullar i institucionit, ***** , Drejtor i Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, ***** , Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, si dhe ***** , specialiste e ngarkuar me detyrat e personelit, (pasi Specialistja e Burimeve Njerëzore në momentin e inspektimit ishte me leje lindje), si personat përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore pjesë e shërbimit civil. Në këtë takim u bisedua dhe u ra dakord për objektin dhe drejtimit të inspektimit, si dhe për dokumentacionin shkresor që duhet të vihet në dispozicion të grupit të inspektimit për verifikim. Si person kontakti me grupin e inspektimit u caktua ***** , Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme.

- Grupi i punës verifikoi pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit;
- Verifikoi procedurat e rekrutimit dhe përmbajtjen e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo të dhënë tjetër, të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil;
- Verifikoi përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standart të miratuar;
- Verifikoi të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si arsimi, përvoja në punë e të tjera;
- Verifikoi praktikat gjyqësore dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në punë të nëpunësve të shërbimit civil.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi 1 dhe Aneksi 2*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti.

Përmbajtja raportit:

I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar deri më datë 31.12.2013 ka qenë pjesë e strukturës dhe organikës së Këshillit të Ministrave dhe si rrjedhojë, duke qenë pjesë e shërbimit civil, procedurat e menaxhimit të shërbimit civil janë administruar nga Departamenti i Administratës Publike.

Me Vendimin nr. 58, dt. 29.01.2004, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, DSIK është organizuar si institucion në varësi të Kryeministrit dhe si i tillë për nëpunësit e kësaj drejtorie është zbatuar dhe vazhdon të zbatohet legjislacioni për shërbimin civil (Ligji nr. 8549, dt.11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, aktualisht Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij) ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 7661, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Miratimi i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, vendosin rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet e administratës shtetërore, që janë pjesë e fushës së veprimtimit të këtij ligji.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin nr. 45, dt. 10.02.2014 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, në bazë të së cilës figuron se numri i punonjësve të kësaj drejtorie është gjithsej 30 veta.

a. Vlerësimi i procesit të ndarjes së pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në institucion.

Sipas Strukturës së përmëndur më sipër, rezulton se institucioni ka gjithsej **30** pozicione pune: **25** janë pozicione që përfshihen në shërbimin civil dhe **5** janë pozicione mbështetëse, të cilat gjejnë rregullim ligjor në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Grupimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nisur nga kategoria dhe klasa e përcaktuar në nenin 19 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, paraqitet në mënyrë skematike si më poshtë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues (TND) **1** vend pune në pozicionin “Drejtor i DSIK”;
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues **3** vende pune në pozicionin “Drejtor Drejtorie”;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues **7** vend pune në pozicionin “Përgjegjës sektor”;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive janë **14** vende pune me emërtesën “specialist”;
- (kategoria IV-a).

Ndërkohë, e parë në këndvështrimin e Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe më konkretisht të Lidhjes nr. 3,

"Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës", e cila është pjesë e këtij vendimi, rezulton se 7 pozicione të kategorisë ekzekutive janë pozicione pune që përfshihen në grupin e administrimit të posaçëm.

Këto pozicione, në kuptim të ligjit, kërkojnë njohuri të posaçme për të realizuar detyrat funksionale dhe bëhet fjalë për:

- *Spektori i Sigurimit të sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit i përbërë nga 1- Përgjegjës Spektori dhe 2- Specialistë,*
- *1-Specialist IT, pjesë e Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështëtese dhe Mbikëqyrjes Shtetërore.*
- *Spektori Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare i përbërë nga 1-përgjegjës sektori dhe 2 Specialistë.*

Konkluzion: Në lidhje me metodologjinë e ndjekur për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në këtë institucion, Komisioneri vlerëson se është bërë një ndarje e drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë funksione administrative. Po kështu, për shkak të natyrës së punës dhe problematikës që trajton kjo drejtori, i drejtë konsiderohet edhe raporti 11 nëpunës të nivelit drejtues me 14 nëpunës të nivelit ekzekutiv.

b. Plotësimi i kushteve ligjore për të përfutuar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që DSIK ka qenë përfshirë dhe përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, deklarimi i statusit të punësimit është bërë në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se, *pika 3: "Nëpunësit civilë ekzistues*, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë"; pika 4: "*Nëpunësit ekzistues* që janë punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civil në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji; pika 6: "*Deklarimi i statusit të punësimit*", sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse, pas verifikimit të procedurës së punësimit".

Ky proces rregullohet në mënyrë të hollësishme edhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.116, datë 05.03.2014 (ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014), "*Për statusin e*

nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", Kreu II dhe III.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si struktura dhe organigrama e mëparshme e institucionit, miratuar me Urdhër të Kryeministrit, nr. 85 dt.21.10.2011, "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar*" ashtu dhe ajo aktuale miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 45, datë 10.02.2014, "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar*", listëprezenca e muajit Shkurt 2014 dhe listëprezenca e muajit Janar 2015; dokumentacioni i plotë që pasqyronte procedurat e konkurimit sipas legjislacionit të shërbimit civil, të realizuara për nëpunësit e emëruar në pozicione pjesë të shërbimit civil; përshkrimet e punës për çdo pozicion, si dhe dosja individuale e çdo nëpunësi civil ekzistues, të dhënat të cilat janë pasqyruar në Anekset 1 dhe 2, pjesë e këtij materiali.

Pasi u analizuan të dhënat e mësipërme, procesi i deklarimit të statusit paraqitet si më poshtë:

a. Verifikimi i procesit të deklarimit të statusit të punësimit

Nga këqyrja e dokumentacionit, rezulton se në këtë institucion nëpunësit ekzistues, janë rekrutuar në pozicione të shërbimit civil, sipas procedurave të rekrutimit të parashikuar në ligjin nr. 8549, dt. 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Duke analizuar materialet e administruara dhe të dhënat e mbledhura rezulton se, për 18 nëpunës, Departamenti i Administratës Publike, si njësia përgjegjëse, me shkresën nr. 19 prot, dt.30.07.2014, "*Verifikimi i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktualë*", ka deklaruar statusin e punësimit "*Nëpunës civil*" dhe për 4 raste "*Nëpunës civil në periudhë prove*", të cilat janë të pasqyruara dhe në **Aneksin nr. 1** të këtij materiali.

Prej nëpunësve që u është deklaruar statusi veçohet rasti i nëpunëses ***** , e cila pas deklarimit të statusit, me kërkesën e saj, ka shkëputur marrëdhëniet financiare (zbatuar me Urdhër nr. 1 dt. 06.01.2015, të Drejtorit të DSIK), pasi ka konkuruar për ngritje në detyrë dhe është emëruar me shkresën nr. 4346, dt. 19.12.2014, të DAP, në pozicionin Inspektor në Njësine e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit në Kryeministri. Pozicioni i saj i punës, Përgjegjës i Sektorit

Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë, aktualisht është i lirë. Po kështu, të lirë janë edhe dy pozicione IT.

Mbështetur në një verifikim të hollësishëm të të dhënave, u konstatua se punonjësit e deklaruar i përmbushnin kriteret e përcaktuara, në pikën 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar si dhe Kreun II dhe Kreun III të Vendimit nr. 116, dt. 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, Kreu III “Statusi i nëpunësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat”*.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se DAP, në procesin e deklarimit të statusit të punësimit ka vepruar drejt dhe brenda afateve, duke i pajisur gjithë nëpunësit me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit.

b. Procedurat konkurruese të kryera në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*.

Nga analiza dhe trajtimi i dokumentacionit që na u vu në dispozicion, grupi i inspektimit konstaton se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar (në datë 26.02.2014), sipas organigramës dhe strukturës në fuqi, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka pasur gjithsej 25 pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se në momentin e mbikëqyrjes janë efektivisht 22 nëpunës civil ekzistues, verifikuar edhe nga listëpagesa dhe struktura analitike për muajin Mars 2015; 3 pozicione janë vakant, ndër të cilët 21 nëpunës janë rekrutuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur; 1 nëpunës emëruar me kontratë të përkohshme, në pozicionin specialist në sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare me urdhrin e titullarit nr. 14, dt. 24.02.2014, duke përfituar në këtë mënyrë nga mundësia që njeh neni 67 i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*. Në këtë mënyrë, ditën e fillimit të efekteve të ligjit në fjalë ka fituar statusin e punësimit *“nëpunëse civile në periudhë prove”*, periudhë të cilën aktualisht e ka përfunduar me sukses.

Nga materialet që na janë vënë në dispozicion, rezulton se për 21 nëpunësit e punësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit të hapur, procedura e rekrutimit ishte realizuar në përputhje me kërkesat e nenit të13 i ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*, duke filluar nga

- shpallja e konkurrimit në dy gazetat me qarkullimin më të madh, të paktën 30 ditë para datës së caktuar për konkurim, së bashku me listën e kërkesave të përgjithshme dhe të

- veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, si dhe fushën në të cilën do të zhvillohej testimi;
- paraseleksionimi i kandidatëve të mundshëm për të kaluar në testimin me shkrim data e testimit;
- krijimi i komitetit *ad hoc*;
- testimi me shkrim;
- vlerësimi përfundimtar i kandidatëve dhe përzgjedhja e fituesit nga eprori direkt dhe botimi i rezultateve të konkurimit po në dy gazeta me qarkullimin më të madh;
- akti i emërimit në shërbimin civil.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se janë zbatuar të gjitha kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8549, dt.11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*", i cili ka qenë në fuqi në momentin e rekrutimit për këto pozicione pune.

Në mënyrë të detajuar veprimet kryesore që materializojnë mënyrën e rekrutimit nëpërmjet konkurimit të hapur apo lëvizjes paralele, janë të pasqyruara në tabelën **Aneksi nr.2**, që i bashkëngjitet raportit si pjesë e tij.

II. Respektimi i kërkesave ligjore në lidhje me hartimin e përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.

a. Ecuria e procesit për hartimin e formularit të përshkrimit të punës.

Grupi i inspektimit verifikoi përshkrimet e punës për të parë nëse janë hartuar në formën që kërkon legjislacioni për shërbimin civil.

Procedura për hartimin e përshkrimit të punës për çdo pozicion që përfshihet në shërbimin civil është përcaktuar me hollësi në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*", Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, "*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*", akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19 të ligjit 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Misioni i institucionit dhe detyrat kryesore për secilin pozicion pune janë të parashikuara dhe të miratuara me urdhrin nr. 1, dt.14.01.2015, të Kryeministrit “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe biseda me Përgjegjës të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, u konstatua se ka pasur një korrespondencë të rregullt me DAP, deri në realizimin e aktit përfundimtar të përshkrimit të punës për secilin pozicion sipas formatit të miratuar. Është bërë saktë ndarja e detyrave dhe për secilin pozicion ishin përcaktuar kritere specifike, në bazë të detyrave që mbulon secili pozicion dhe të sqaruara mjaft qartë në rregulloren e brendshme të institucionit.

Duke qenë se, nga Struktura aktuale rezulton që 7 pozicione të kategorisë ekzekutive, përfshihen në grupin e administrimit të posaçëm, u verifikuan në mënyrë të detajuar përshkrimet e punës, këto pozicione, në kuptim të ligjit, kërkojnë njohuri të posaçme për të realizuar detyrat funksionale kështu që:

- Sektori i Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit i përbërë nga 1-përgjegjës Sektori dhe 2- Specialistë, në përshkrimin e punës ishte specifikuar lloji i arsimimit si kërkesë e veçantë;
- *1-Specialist IT, pjesë e Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes shtetërore.*
 - o Master shkencor, në fusha si shkenca kompjuterike, siguri informacioni, inxhinieri komunikimi, inxhinieri software, inxhinieri elektronike, rrjeta kompjuterike ose fusha ekuivalente ose të ketë eksperiencë praktike të ngjashme;
- *Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare i përbërë nga 1-përgjegjës sektori dhe 2 Specialistë;*
 - o Master shkencor për Drejtësi (për të tre pozicionet)

Megjithatë u konstatua se ky akt ndodhej në dosjen personale të nëpunësit, por që ky dokument të jetë i vlefshëm, duhet të jetë i firmosur në rubrikën “nënshkrimi”, nga nëpunësi dhe eprorët sipas nivelit hierarkik.

Mungesa e këtij elementi, në kuptim të legjislacionit të shërbimit civil, bën që procesi i përgatitjes dhe hartimit të përshkrimeve të punës të konsiderohet i papërfunduar, gjë e cila duhet të rregullohet menjëherë.

Konkluzion: Për rregullimin e situatës rekomandojmë që njësia përgjegjëse e institucionit (Drejtoria e Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore) duhet të kryejë

menjëherë procesin e “Nënshkrimit” të përshkrimeve të punës nga nëpunësi përgjegjës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Në observacionin e ***** , pretendohet se Formularët e Përshkrimit të Punës janë plotësuar sipas procedurave të përcaktuara në V.K.M Nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pasi janë hedhur në formatin elektronik në programin Google-Drive brenda afatit të kërkuar dhe administrohen nga DAP dhe për rrjedhojë ky format nuk kërkon dhe nuk bën të mundur nënshkrimin e nëpunësve dhe eprorëve përkatës, duke qenë se plotësohet në rrugë elektronike.

Komisioneri vlerëson se, edhe pse ky detyrim është përmbushur në kuptimin e plotësimit të formularëve sipas formatit të kërkuar, brenda datës 20.05.2015, nënshkrimi i këtyre formularëve të përshkrimit të punës nga ana e nëpunësit dhe eprorit direkt është një detyrim më vehte, i kërkuar nga nenet 18, 20 dhe 21 të V.K.M Nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”. Dispozitat e mësipërme përcaktojnë se përshkrimet e punës për institucionet në varësi të Kryeministrit duhet të miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave. Njëkohësisht, në këtë vendim parashikohet e drejta e DAP për të rikthyer për rishikim përshkrimet e punës dhe vetëm pas miratimit ato depozitohen në Departamentin e Administratës Publike.

Gjithashtu, referuar Kreut XIII, lidhjes 4 të vendimit nr. 142/2014, në formularin e përshkrimit të punës, parashikohet dhe Seksioni i “Nënshkrimeve”, ku përcaktohet detyrimi i nëpunësit dhe eprorit direkt për të nënshkruar formularin e përshkrimit të punës në formë shkresore, dhe kjo kopje duhet të vendoset në dosjen individuale të personelit, në mënyrë që kushdo, në çdo kohë, të marrë dijeni për të dhënat që përmban ky dokument.

b. Zbatimi i nenit 21 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, në lidhje me kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për pranimin në shërbimin civil.

i. Respektimi i kërkesave të përgjithshme për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, për secilin nëpunës u kontrolluan dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga shkronja “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Grupi i inspektimit konstatoi se në dosjen personale të secilit punonjës kishte vërtetim të gjendjes gjyqësore elektronike, kjo për të provuar faktin se kandidatët nuk kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje. Gjithashtu, dosjet e secilit nëpunës përmbanin raportin mjeko-ligjor të marrë në 6-mujorin e parë të vitit.

ii. Respektimi i kërkesave të posaçme të vendit të punës nga çdo nëpunës që është pjesë e shërbimit civil.

Për të verifikuar plotësimin e kërkesave specifike të vendit të punës, grupi i punës shqyrtoi formularët e përshkrimit të punës, për çdo pozicion pune të shërbimit civil, si dhe të dhënat individuale të çdo nëpunësi lidhur me nivelin dhe fushën kryesore të studimeve (*diplomën e studimeve universitare, listën e notave*), ndërsa për të verifikuar plotësimin e kriterit të përvojës në punë, u shqyrtua librezja e punës, për të vërtetuar nëse nëpunësi ka patur/nuk ka patur përvojë pune, sipas kërkesave në momentin e rekrutimit nëpërmjet konkurimit.

Konkluzion: Në përfundim të analizës që i është bërë, Komisioneri konstaton se nëpunësit e emëruar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për pranimin në shërbimin civil, referuar nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*".

Të dhënat për çdo punonjës, sipas dokumentacionit të administruar në dosjet individuale, janë të pasqyruara në tabelën **Aneksi nr.3**, "*Respektimi i kërkesave të përgjithëshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion*".

c. Organizimi i Dosjes dhe Regjistrimit të Personelit.

➤ Dosja e personelit.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen e personelit, si një dokument i krijuar në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", rezulton se janë të administruara dokumentet e identifikimit (*fotokopje e pasaportës*); dokumente që tregojnë për gjendjen civile (*certifikata e gjendjes familjare*); dokumente që vërtetojnë edukimin arsimor (*diploma e shkollës së lartë*); dokumente që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (*akti i emërimit*); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (*certifikata kualifikimi*), etj.

Administrimin e këtyre akteve në dosjen e individuale të nëpunësit civil e kërkon në mënyrë të shprehur, pika 2 e Kreut I, të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, si dhe lidhja 1 dhe 2, pjesë të këtij vendimi.

Plotësimi i këtyre kërkesave është pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Aneksin nr. 3** që është pjesë e këtij materiali.

Konkluzion: Komisioneri konstaton se, dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Specialisti i Burimeve Njerëzore, që është nëpunës përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

d. Regjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument i krijuar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Në kushtet kur ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në mënyrë specifike, sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i institucionit, pasqyrojnë gjëndjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

e. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimi në shërbimin civil, në zbatim në pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, “*Plani vjetor i pranimi në shërbimin civil*”, Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka miratuar planin e rekrutimeve me shkresën e dt. 27.02.2015, “*Plani vjetor i pranimi në shërbimin civil për vitin 2015 në DSIK*”. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstatoi përputhshmërinë e planit të pranimi në shërbimin civil për vitin në vazhdim, me strukturën analitike ekzistuese dhe listëpagesën e DSIK.

f. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me vlerësimin e nëpunësve civilë të DSIK për vitin 2014.

Sipas dokumentacionit të inspektuar pranë DSIK-së rezulton se, vlerësimet e punës për çdo nëpunës civil të këtij institucioni janë realizuar sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Ministratve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* dhe V.K.M nr.109, dt. 26.02.2014, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil”*.

Në kuadrin e vlerësimeve vjetore, rezulton se nga institucioni janë kryer vlerësimet vjetore për 20 nëpunës civilë të DSIK, pasi titullari i këtij institucioni është anëtar TND dhe vlerësimi i rezultateve në punë të këtij nëpunësi kryhet nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, kjo në referencë të nenit 31 të ligjit nr. 152/2013. Nga ana tjetër, rezulton se për nëpunësin civil Migena Boriçi, nuk është kryer vlerësimi vjetor për shkak të lejes së lindjes.

Nga titullari i këtij institucioni, në cilësinë e zyrtarit raportues rezulton të jenë kryer 4 vlerësime vjetore, me shënime të përkatëse, korrekte, në gjithë rubrikat e komenteve dhe shpjegimeve, duke i dhënë përgjigje gjithë zërave që lidhen me objektivin që duhet të realizojë çdo nëpunës, ndërsa për 16 nëpunës civilë të DSIK, vlerësimet janë bërë nga zyrtarë raportues të tjerë, sipas hierarkisë.

Nga këqyrja e dokumentacionit objekt inspektimi, rezulton se për 7 nëpunës civil, vlerësimet vjetore nuk janë të plota, pasi në rubrikën e shpjegimeve nuk janë bërë komente për të gjitha zërat që kërkon formulari i vlerësimeve. Konkretisht, rezulton se për nëpunësit civilë ***** ; ***** , ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** nga zyrtarët raportues, eprorët direkt të përkatës, nuk janë bërë shënime në rubrikën “Sjellje profesionale”, ku duhet të jepen komentet në lidhje me realizimin e punës me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara, në interesimin në përmbushjen e detyrave të pozicionit apo bashkëpunimit në grup, të dhëna këto që janë të nevojshme për kryerjen e një vlerësimi sa më të plotë e objektiv.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se konstatimi i grupit të inspektimit është i drejtë dhe pse në observacionin e ***** , parashtrohet se *“...komentet nuk janë detyruese për zyrtarin raportues apo eprorin direkt të përkatës, mjafton të jetë bërë pikëzimi, që në rastet e përmendura është realizuar tërësisht prej zyrtarëve raportues dhe eprorëve direkt për nëpunësit të përkatës”*.

Komisioneri çmon se, procedura e vlerësimit të nëpunësit civil, sipas formatit të miratuar nga DAP, nuk duhet të konsistojë vetëm në vlerësimin me pikë, por duhet të shoqërohen edhe me komentet të përkatës me rekomandimet dhe vërejtjet e nevojshme, të parashikuara në formularin e vlerësimit. Respektimi i këtij detyrimi ligjor, ndikon në një vlerësim më objektiv dhe te efektshëm të performancës dhe arritjeve të nëpunësit civil gjatë kryerjes së detyrave të tij dhe për më tepër, ndihmon nëpunësin që në të ardhmen të përqendrohet në ato drejtime të treguara, me qëllim përmbushjen sa më mirë të detyrave dhe nxitjen e rritjes së performancës në punë.

- g. Mbi disa vendime gjyqësore të formës së prerë, me objekt rikthimin në punë, për ish punonjës të DSIK, që pretendohet se nuk zbatohen për shkaqe subjektive.

Në lidhje me këtë problem u hetua nëse kishte çështje apo vendime gjyqësore të ish punonjësve të DSIK, larguar nga shërbimi civil, nëse këto vendime janë kthyer në tituj ekzekutivë dhe nëse janë nxjerrë pengesa subjektive për zbatimin e titujve ekzekutivë.

U konstatua se gjatë viteve 2013 – 2014 janë ndjekur e zhvilluar 5 procese administrativo-gjyqësore, në të cilët janë përfshirë punonjësit ***** – Specialiste (*Juriste*) në Sektorin Juridik e Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë Juridike, Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Shërbimeve Mbështetëse; ***** - Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit Teknologjik dhe Industrial; ***** – kërkesë për emërim nga lista e pritjes, në pozicionin - Përgjegjës i Sektorit të Financës, Buxhetit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse; ***** – Specialist i Sektorit të Administrimit të Dokumenteve në Drejtorinë e Sigurisë dhe Administrimin e Dokumenteve; ***** – Specialist i Sigurimit dhe Informacionit & Korrier Diplomatik, në Drejtorinë e Vetting-ut dhe Regjistrin Qendror.

Më poshtë po rendisim dhe përshkruajmë në mënyrë të detajuar, gjithë proceset gjyqësore, natyrën e mosmarrëveshjes që kanë përbërë thelbin e tyre, fazën në të cilën këto procese ndodhen aktualisht dhe nëse është i drejtë pretendimi se këto vendime nuk zbatohen për shkaqe subjektive.

Rrethanat e çështjes gjyqësore ngritur prej nëpunësës *****

***** është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove me Urdhrin nr. 172, datë 1.10.2009, “*Për emërim në detyrë*” si Specialiste (*Juriste*) në Sektorin Juridik e Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë Juridike, Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

Pas mbarimit të periudhës së provës dhe të vlerësimit të rezultateve individuale në punë, *** , konfirmohet si nëpunës civil me Urdhrin nr.140, datë 18.10.2010, në pozicionin Specialist (Jurist), në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë Juridike, Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Me datë 11.04.2013, ndaj nëpunësës ***** , ka filluar procedura disiplinore dhe me shkresën nr. 28 Prot., datë 05.06.2013, “*Komunikim i vendimit për masë disiplinore*”, i është komunikuar akti nr. 19, datë 22.04.2013, për largim nga shërbimi civil.

Kjo masë disiplinore, mbi bazën e kërkesës së saj, është shqyrtuar nga Komisioni i Shërbimit Civil i cili me vendimin nr.156, datë 16.07.2013, ka rrëzuar kërkesën, vendim i cili u atakua në rrugë gjyqësore. Gjykata, me vendimin nr. 12735, datë 19.12.2013, të ka vendosur prishjen e vendimit të KSHC dhe rikthimin e paditëses në vendin e saj të punës.

Ky vendim, është ankimuar në Gjykatën e Apelit nga ana e institucionit (*ankimi dërguar me shkresën nr. 202, datë. 30.01.2014*) dhe akoma nuk është shqyrtuar.

Rrethanat e çështjes gjyqësore ngritur prej nëpunësit *****

***** ka filluar punë si nënpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit Teknologjik dhe Industrial me aktin nr. 64, datë 30.05.2008, të Drejtorit të DSIK-së.

Me aktin nr. 91, datë 22.06.2009, është konfirmuar nga Drejtori i DSIK-së si nënpunës civil në këtë pozicion.

Me vendimin nr 62, datë 06.04.2011, ***** është liruar nga shërbimi civil me motivacionin se ka mbushur moshën e pensionit.

Ndaj këtij akti, i sipërpërmenduri ka paraqitur ankim në Komisionin e Shërbimit Civil, i cili me vendimin nr.139, dt 03.06.2011, ka vendosur rrëzimin e ankesës.

Ndaj këtij vendimi është hapur një proces gjyqësor, i cili pas disa gjykimesh e rigjykimesh, vazhdon akoma në Gjykatën e Apelit, ku pritet shqyrtimi.

Rrethanat e çështjes gjyqësore ngritur prej nëpunësit *****

***** ka qenë nëpunës në listëpritje me status të nëpunësit civil dhe, gjatë periudhës që zhvillohej konkursi për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Financës, Buxhetit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse” në DSIK, ka aplikuar pranë DAP për emërim direkt nga lista e pritjes.

Meqenëse, nuk pati reagim pozitiv nga ana e organit menaxhues, në datë 25.08.2009, ***** ka depozituar ankim pranë Komisionit të Shërbimit Civil, duke kërkuar anullimin e konkurimit dhe shqyrtimin e kërkesës së tij për emërim nga lista e pritjes.

Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr. 50, dt.20.10.2009, ka anuluar konkurimin për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Financës, Buxhetit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, vendim i cili nuk u apelua dhe, si rrjedhojë, ka marrë formë të prerë.

Në kuadër të zbatimit të këtij vendimi është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr. 3108, dt. 22.10.2010, dhe ka filluar procedura e zbatimit të detyrueshëm nga ana e shërbimit përmbartimor.

Ky titull ekzekutiv është atakuar nga ana e DSIK-së me padinë e protokolluar nr. 1619, dt.15.12.2010, me objekt për pavlefshmëri absolute të titullit ekzekutiv. Kjo padi është pranuar nga shkalla e parë dhe e dytë e gjykimit, duke ndryshuar vendimin e KSHC dhe duke rrëzuar pretendimet e *****.

Nga ky i fundit është ushtruar rekurs, i cili nuk është shqyrtuar akoma.

Rrethanat e çështjes gjyqësore ngritur prej nëpunësit *****

Ky nëpunës ka filluar punë në DSIK me aktin nr. 1436/1 prot., dt. 09.12.2003, në pozicionin, Specialist i Sektorit të Administrimit të Dokumentave në Drejtorinë e Sigurisë dhe Administrimin e Dokumenteve (në periudhë prove) dhe me aktin nr.16, dt. 06.01.2005, është bërë konfirmimi i statusit të nëpunësit civil.

Me aktin administrativ nr. 18, dt. 22.09.2008, ndaj tij është marrë masa disiplinore largim nga shërbimi civil dhe me vendim nr. 146, dt. 23.10.2008, i është hequr dhe Certifikata e Sigurisë.

Mbi bazën e kërkesës së këtij nëpunësi, Komisioni i Shërbimit Civil e ka trajtuar këtë çështje dhe me vendimin nr. 160, dt. 23.10.2008, ka vendosur ndryshimin e aktit administrativ për largimin nga shërbimi civil të ***** dhe kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, si dhe detyrimin e institucionit t'i paguajë pagën për sa kohë ai qëndron i papunë.

Kundër këtij vendimi nuk është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, si rrjedhojë, ky vendim ka marrë formë të prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

DSIK, meqë ka humbur afatin e ankimit ndaj vendimit të KSHC, ka bërë kërkesë për rivendosje në afat të ankimit, proces i cili është në gjykim.

Rrethanat e çështjes gjyqësore ngritur prej nëpunësit *****

Pas kryerjes së procedurave të konkurimit, ***** me urdhrin nr. 120, dt. 13.08.2012, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Specialist i Sigurimit dhe Informacionit & Korrier Diplomatik, në Sektorin e Regjistrimit Qendror, në Drejtorinë e Vetting-ut dhe Regjistrimit Qendror. Me urdhrin nr.37/1, dt.05.08.2008, është pajisur edhe me certifikatë sigurie.

Me aktin nr.105, dt.19.07.2013, është vendosur lirimi i tij nga shërbimi civil pasi me një akt të mëparshëm (nr. 104 dt. 19.07.2013), atij i ishte hequr certifikata e sigurisë, gjë e cila përbën kusht për të kryer detyrën e korrierit, etj.

Mbi bazën e ankesës së tij, çështja është e shqyrtuar nga KSHC, i cili me vendimin nr. 190 dt. 26.09.2013, ka vendosur ndryshimin e aktit administrativ dhe kthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës, si dhe detyrimin e institucionit të paguajë pagën e plotë, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare dhe deri në ekzekutimin e plotë të vendimit.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit dhe me vendimin nr. 25, dt.17.09.2014, të po kësaj gjykate është lëshuar dhe urdhri i ekzekutimit.

Çështja, aktualisht, është në fazën që shërbimi përmbarimor ka filluar procedurat e zbatimit të detyrueshëm. Ndërkohë, nga ana e institucionit është depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë. Deri në këtë moment nuk ka vendim për pezullimin e ekzekutimit.

Konkluzion.

Asnjë nga praktikat e përmendura më sipër nuk mund të konsiderohet si rast moszbatimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për shkaqe subjektive.

Në gjithë këto raste kemi të bëjmë ose me vendime që nuk kanë marrë formë të prerë dhe janë në gjykim e sipër në shkallë të ndryshme të gjyqësorisë, ose janë në fazën që akoma nuk kanë filluar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm nga shërbimi përmbarimor.

Pra, në asnjë rast nuk mund të thuhet se ka patur pengesa subjektive në zbatimin e vendimeve. Megjithatë, institucioni duhet të përgatitet, sidomos duke rritur komunikimin dhe bashkëpunimin me njësinë përgjegjëse (*Departamentin e Administratës Publike*) për marrjen e masave, për zbatimin e atyre vendimeve të kthyera apo që do të kthehen në tituj ekzekutivë. Ky detyrim rrjedh prej nenit 66/1 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar me ligjin nr. 178, dt. 18.12.2014, i cili parashikon detyrimin pa kushte, për sistemimin e punonjësve që kanë vendime gjyqësore për kthim në punë. Për më tepër, sistemimi i nëpunësve të kësaj kategorie, ka përparësi, sapo të krijohet një vend i lirë pune.

Problemi në lidhje me zbatimin e tyre është fakti i zënies së pozicioneve të punës të këtyre punonjësve të larguar me masa disiplinore, nga punonjës të tjerë, të cilët kanë hyrë në shërbimin civil në vend të tyre, nëpërmjet procedurave të rregullta të konkurimit, nga pikëpamja formale. Në përmbajtjen e tyre, këto pozicione të liruara për shkak të masave disiplinore për largim nga puna, të marra ndaj nëpunësve që punonin më parë në këto vende pune, nuk duhet të konsideroheshin pozicione të lira, pasi në kuptim të ligjit, pozicione të lira, që mund të plotësohen nëpërmjet procedurave të konkurimit duhej të konsideroheshin ato pozicione që krijohen si rezultat i shtimit apo riorganizimit të pozicioneve të reja të punës për shkak ristrukturimit, shtimit të kompetencave të organit administrativ, pranimit të dorëheqjes nga nëpunësi civil, mbushjes së moshës për pension, etj.

Nga shqyrtimi i korrespondencës së institucionit të DSIK, me njësinë përgjegjëse (*Departamenti i Administratës Publike*) rezulton se ka përpjekje për sigurimin e zbatimit të vendimeve, përpjekje këto që kanë marrë dhe formë konkrete, si psh., për rastin ***** , vendimi i të cilit është kthyer në titull ekzekutiv (*pavarësisht, se ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë*) ka filluar zbatimi i efektit ekonomik të tij, duke lëvruar një pjesë të detyrimit për pagën. Po kështu, ka filluar korrespondenca me njësinë përgjegjëse, për sistemimin e tij në punë, në një pozicion të shërbimit civil, për shkak se vendi i mëparshëm i tij i punës, me strukturën aktuale është suprimuar (*shih shkresën nr. 2079, dt. 26.09.2014, të DSIK, me të cilën kërkohet mendim për mënyrën e veprimit; shkresën 2647/1, dt. 30.10.2014, me të cilën DAP orienton zbatimin pa kushte të vendimit gjyqësor; shkresën nr. 708, dt. 27.02.2015, ku DSIK, me qëllim uljen e efektit financiar të vendimit, kërkon mundësinë e një emërimi të përkohshëm të ***** , ndërkohë që është në listë pritje në bazë të nenit 66/1 të ligjit “Për nëpunësin civil”, por që ka mbetur pa përgjigje..., etj.*). Komunikimi vazhdon dhe ndërkohë, në kuadrin e planifikimit të ndryshimit të strukturës dhe pranimeve në shërbimin civil për vitin në vazhdim, janë kërkuar shtim të disa pozicioneve të punës, me qëllim zgjidhjen edhe të këtyre situatave që krijohen nga zbatimi i vendimeve.

Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim të pandërprerë me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, në rastin e vendimeve të cilat kanë marrë formë të prerë dhe parashikojnë kthimin në vendin e punës të nëpunësit civil, duhet t’i drejtohet me shkrim nëpunësit kreditor, për sistemimin e tij në një nga pozicionet e lira, të mundshme, të administratës shtetërore, ku ata plotëson kërkesat e përgjithshme e të posaçme dhe të kërkojnë prej tij deklarin e pranimit të pozicionit të ofruar. Në rast të pranimit të pozicionit të ofruar, shënohet përmbushja e detyrimit nga ana e organit administrativ debitor, por nga ana tjetër, në interpretim të nenit 66/1 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të konsiderohet detyrim i përmbushur edhe refuzimi me shkrim, pa shkaqe të arsyeshme, i pozicionit të ofruar.

Referuar observacioneve të bëra nga DSIK në lidhje me proceset gjyqësore, Komisioneri sqaron se nga ana e grupit të inspektimit është bërë vetëm evidentimi i fakteve dhe rrethanave të proceseve gjyqësore.

Në observacion, nga ana e DSIK, parashtrohet se në rastin e ***** , nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për të shpallur procedurat e konkurimit për vendet e lira që dispononte, për arsye se çdo konkurs për këto vende është realizuar para shpalljes së vendimit të formës së prerë, të ***** dhe në kuadër të parimit të efikasitetit dhe efektivitetit, nuk mund të lihen pozicione pune të lira deri në shpalljen e vendimit përfundimtar.

Komisioneri sqaron se plotësimi i pozicioneve të lira të punës, të krijuara për shkak të largimit të nëpunësve me masa disiplinore, nuk duhet të bëhet nëpërmjet procedurës së konkurimit, pasi kjo përbën një shkelje të rregullave të menaxhimit të shërbimit civil. Për këto pozicione, të cilat në referencë të ligjit nr. 8459, dt.11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*" nuk konsiderohen pozicione të lira, legjislacioni që ka qënë në fuqi lejonte plotësimin e tyre me emërim të përkohshëm, në kushtet e emergjencës, referuar dhe Urdhrit nr. 41, dt. 29.01.2004, të Kryeministrit, bazë ligjore e cila është përdorur edhe nga institucioni i DSIK, në disa nga emërimet e nëpunësve të tij.

Si rrjedhim, Komisioneri vlerëson se nga ana e DSIK nuk janë respektuar kërkesat ligjore për plotësimin e pozicioneve të lira të krijuara si rrjedhojë e marrjes së masave disiplinore, kjo dhe në referencë të nenit 66 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", ku renditen pozicionet e lira. Në kuadër të shmangies së mbingarkesave financiare në buxhetin e institucionit dhe të menaxhimit sa më efektiv të shërbimit civil në të ardhmen, Komisioneri konkludon se nga ana e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar duhet të ishin vlerësuar dhe zbatuar të gjitha mjetet që parashikonte ligji i kohës për plotësimin e këtyre pozicioneve të lira.

h. Disa shkelje dhe parregullsi të konstatuara në menaxhimin e shërbimit civil nga ana e njësisë të burimeve njerëzore, për disa nëpunës civil të DSIK.

Për realizimin e një inspektimi sa më të plotë, referuar kompetencave të përcaktuara në nenin 14 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", prej Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil u trajtua dhe material shtesë, i sjellë nga DSIK, me shkresën nr. 1422 prot., dt. 24.04.2015.

Pas këqyrjes së dokumentacionit, prej grupit të inspektimit, për disa nëpunës civil të këtij institucioni u evidentuan parregullsi në respektimin e kërkesave ligjore për disa aspekte të menaxhimit të shërbimit civil, për të cilat ligji parashikon rregullimet përkatëse, të cilat paraqiten si më poshtë:

***** - Ka konkuruar për pozicionin “*Specialist pranë Drejtorit*”; shpallja e vendit vakant të të cilit është bërë me shkresën nr. 89, dt. 27.06.2013. Për këtë vend vakant janë paraqitur 5 kandidatë, për të cilët sipas ligjit, fillimisht është bërë verifikimi i dokumentacionit përkatës. Sipas shkresës nr. 107 prot., dt. 01.08.2013, kandidatja ***** është skualifikuar për mungesë dokumentacioni dhe si kandidatë që plotësojnë kushtet për të hyrë në testim janë renditur: ***** , ***** , ***** dhe *****.

Konkursi është zhvilluar më datë 20.08.2013, por me procesverbal “Për situatë të jashtëzakonshme gjatë zhvillimit të konkursit për pozicionin “*Specialist pranë Drejtorit*”, është vendosur që konkursi të zhvillohet në datë tjetër për shkak të mospjesëmarrjes në testim të kandidatës ***** dhe mosplotësimit të numrit minimal të kandidatëve pjesëmarrës në testim. Testimi është zhvilluar me datë 02.09.2013, fakt që vërtetohet me procesverbalin e verifikimit të prezencës gjatë zhvillimit të konkursit.

Në testimin e mësipërm (për të cilin nuk është vënë në dispozicion tabela e vlerësimit të kandidatëve), konstatohet se në procedurën e konkurimit për pozicionin “*Specialist pranë Drejtorit*” kanë marrë pjesë ***** dhe ***** , të cilat kanë patur lidhje gjinore (pasi janë motra).

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se pjesëmarrja e dy motrave në një proces konkurimi, për të njëjtin pozicion pune, nuk përbën pengesë të drejtpërdrejtë ligjore për vlefshmërinë e procesit, në kushtet e një pjesëmarrjeje të kufizuar të kandidatëve në procesin e konkurimit, krijon premisa për lindjen e mendimit se jemi para një procedure që vjen në kundërshtim me parimet e konkurimit të hapur dhe meritokracisë. Kjo duhet mbajtur parasysh për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Joana Ramaj- Ka konkuruar për pozicionin Specialist në Sektorin e Administrimit të Dokumenteve në Drejtorinë e Sigurisë dhe Administrimit të Dokumenteve në DSIK, shpallja e vendit vakant të të cilit është bërë me shkresën nr. 88, dt. 27.06.2013, në të cilën janë përcaktuar dhe kërkesat për pozicionin e punës.

Me shkresën nr. 107 prot., dt. 01.08.2013, është bërë verifikimi i kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për të marrë pjesë dhe ndër kandidatë të mundshëm janë renditur ***** ; *****

***** ; ***** dhe ***** , të cilët janë të gjithë kandidatë jashtë DSIK. Testimi është mbajtur më datë 20.08.2013, për të cilin nga komiteti *ad-hoc* janë mbajtur procesverbali për verifikimin e prezencës së pjesëmarrësve dhe procesverbalin për renditjen e kandidatëve sipas pikëve të fituara, ku e para renditet ***** me 57 pikë.

Në lidhje me konstatimin e bërë nga grupi i inspektimit për procedurën e konkurimit të nëpunës ***** , Komisioneri, pas verifikimit të observacioneve të sjella nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, vlerëson se ky konstatim është i pasaktë.

***** - Fillimisht ka konkuruar për pozicionin specialist-jurist në Sektorin Juridik të Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Administratës, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar. Shpallja e pozicionit të lirë është bërë me shkresën nr. 159, dt. 26.12.2006, dhe për këtë pozicion pune janë paraqitur 5 kandidatë të cilët plotësojnë kushtet e nevojshme për të marrë pjesë në testim, të cilët janë ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** . Sipas procesverbalit të testimit, kandidatja ***** është renditur ndër 3 kandidatët më të mirë dhe me Urdhrin nr. 14, dt. 16.03.2007, është bërë emërimi i saj në pozicionin e mësipërm si nëpunës civil në periudhë prove. Me mbarimin e periudhës së proves, me Urdhrin nr. 29, dt. 20.03.2008, për ***** është bërë konfirmimi si nëpunës civil.

Në vitin 2009, ***** ka konkuruar për pozicionin *“Përgjegjës Sektori, në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë”*. Me shkresën e datës 20.07.2009 ka shprehur vullnetin e saj për të marrë pjesë në këtë konkurim dhe pas procedurës së konkurimit, me Urdhrin nr 163/2, dt. 09.09.2009, është emëruar Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Me urdhrin nr. 146, dt. 31.08.2009, të Drejtorit është miratuar pjesëmarrja e nëpunëses ***** në programin e masterit *“LLM in European and International Law”*, sipas së cilit trajnimi do të zgjasë në periudhën 01.09.2009 - 31.08.2010. Me shkresën nr. 387 prot., dt. 23.02.2009, të drejtorit të DSIK drejtuar Ambasadës së Hollandës, është bërë propozimi për pjesëmarrjen e nëpunëses ***** në trajnimin e internshipit. Në këtë shkresë deklarohet se nëpunëses ***** do t'i paguhet paga prej DSIK gjatë gjithë periudhës së trajnimit dhe se do t'i garantohet vendi i punës ose një vend tjetër i barazvlefshëm me të, pas kthimit nga trajnimi.

Nga grupi i inspektimit u konstatua se në bazë të listëpagesave të sjella nga DSIK dhe më pas të observacioneve të sjella me shkresën nr. 1581 Prot., datë 20.05.2015, rezulton se nëpunësja ***** është paguar për të gjithë periudhën e trajnimit.

Në bazë të nenit 22, pika 2/ç të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*, në të cilin përcaktohet se:

“Nëpunësi civil pezullohet:

ç) për periudha studimi më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vetë nëpunësit, por në lidhje me profesionin që ai ushtron”, institucioni, duhet të kishte bërë pezullimin e nëpunëses ***** për periudhën e trajnimit, ashtu siç përcakton pika 17 e Kreut IV të VKM nr. 315 dt. 23.06.2009 *“Për krijimin dhe funksionimin e ITAP dhe trajnimin e nëpunësit civil”*(i ndryshuar me VKM nr. 242/2004 dhe nr. 292/2005) .

Nga ana tjetër, grupi i inspektimit ka konstatuar se në kundërshtim me pikën 20 të këtij vendimi, ku thuhet: *“...për trajnimet mbi 6 muaj, të ndërmarra me iniciativën e vetë nëpunësit, ai nuk paguhet”*, pavarësisht se nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se trajnimi i punonjësës ***** është bërë në kuadër programeve të trajnimit dhe me miratim të Departamentit të Administratës Publike, në bazë të listëpagesa/borderove të kohës, të vëna në dispozicion nga Zyra

e Financës, vërtetohet se nëpunësja ***** , është paguar pa të drejtë për gjithë periudhën 12 mujore të trajnimit, gjë e cila përbën shkelje të disiplinës financiare dhe dëmtim të arkës së shtetit.

Një parregullsi tjetër e konstatuar nga grupi i inspektimit që vërehet në rastin e ***** është fakti që është konfirmuar në fund të periudhës së provës si nëpunës civil në pozicionin Përgjegjës në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në një kohë që ajo nuk ka punuar asnjë ditë në atë funksion dhe pozicion pune, pasi për gjithë periudhën e provës ajo ishte në trajnim jashtë vendit. Në rastin konkret, veprimi i drejtë do të ishte që periudha e provës të përsëritej dhe vetëm pas kësaj të bëhej vlerësimi nëse kishte vend për konfirmim ose jo.

Megjithatë, pavarësisht shkeljeve të lejuara nga njësia e burimeve njerëzore të DSIK, nëpunësja ***** ka përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil, në bazë të nenit 67/3 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, pasi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ***** ka qenë në pozicionin *“Përgjegjës Sektori në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë”* mbi një vit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se në zbatim të nenit 22, pika 2/ç të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999, *“Për statusin e nëpunësit civil”*, ku **përcaktohet se statusi i nëpunësit civil pezullohet për periudha studimi për më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vetë nëpunësit, por në lidhje me profesionin që ushtron,** konstatimi i grupit të inspektimit është i saktë. Ky detyrim ligjor përcaktohet dhe në V.K.M. Nr. 315, datë 23.06.2009, *“Për krijimin dhe funksionimin e ITAP dhe trajnimin e nëpunësit civil”*, i ndryshuar.

Veç sa më sipër, në observacionin e sjellë nga DSIK, parashtrohet se pagesa për nëpunësen ***** për periudhën e trajnimit është bërë në referencë të nenit 20, pika h, të ligjit nr.8549/1999, *“Statusi i nëpunësit civil”* dhe të pikës 16 dhe 19 të V.K.M nr. 135, datë 23.06.2000, *“Për krijimin dhe funksionimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësit civil”*.

Komisioneri vëren se këto dispozita bëjnë fjalë për të drejtën e nëpunësit civil për trajnim periodik dhe të paguar nga shteti, por ato duhet të shikohen dhe të zbatohen të lidhura ngushtë me nenin 22, pika 2/ç, në të cilën kërkohet shprehimisht pezullimi i nëpunësit civil gjatë periudhës së studimit për më shumë se 6 muaj.

Në lidhje me pretendimet e DSIK-së se në rastin e pagesës së nëpunëses ***** nuk ka dëm ekonomik, pasi në këtë përfundim kanë arritur si Kontrolli i Lartë i Shtetit, në raportin për auditimin e ushtruar në DSIK *“Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar për periudhën 01.01.2008-30.09.2010”*, ashtu dhe Ministria e Financave në Raportin e Investigimit të kryer nga DSIK për periudhën Gusht 2009 - Qershor 2014, edhe pas administrimit të raportit të KLSH, Komisioneri konstaton se ndodhemi para rastit të gjësë së gjykuar dhe kërkon të mos dalë në konkluzion.

Njëkohësisht, në observacion parashtrohet se nëpunëses ***** konfirmimi i statusit të nëpunësit civil të nëpunëses ***** , për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Marrëdhëniet me Jashtë”* i është shtyrë 2 muaj dhe se konfirmimi i është bërë mbi bazën e performancës në punë nga muaji Mars 2007 e në vazhdim.

Komisioneri vlerëson se në referencë të nenit 14, të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*, vendimi për konfirmimin e nëpunësit civil pas përfundimit të periudhës së provës merret mbi bazën e vlerësimit të rezultateve individuale në punë dhe sipas kësaj dispozite periudha e provës fillon nga data e aktit të emërimit. Në ratin konkret, eprori direkt nuk duhet të kishte konfirmuar nëpunësen ***** për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Marrëdhëniet me Jashtë”*, por duhet të kishte përsëritur ose të kishte zgjidhur një herë të vetme për 6 muaj, periudhën e provës.

Në lidhje me pretendimet e DSIK-së të paraqitura në observacion se: *“...në përmbajtje ky program inspektimi është kontradiktor, pasi nuk përputhet me objektin e inspektimit të përcaktuar më sipër dhe periudhën e inspektimit të kërkuar nga ju...”*, Komisioneri sqaron se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, Komisioneri në ushtrimin e kompetencave të tij ka të drejtën e kryerjes së një hetimi të plotë administrativ, të këqyrë dhe inspektojë çdo praktikë administrimi në çdo institucion që punëson nëpunës civilë, të marrë çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij, si dhe të inspektojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me administrimin e shërbimit civil. Në bazë të pikës 3 të nenit të sipërpërmendur, institucionet që punësojnë nëpunës civilë, që kanë kompetenca në administrimin e shërbimit civil apo që kanë informacion në këtë fushë, kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Komisionerin.

Gjatë kryerjes së inspektimit në institucionin e DSIK, nga ana e Komisionerit nuk janë ushtruar kompetenca të cilat nuk parashikohen nga ligji. Procesi i deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësit e çdo institucioni që punëson nëpunës civil, në bazë të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, kërkon të verifikohet imtësisht mënyra e pranimi në punë dhe kohëzgjatja e marrëdhënies së punës për cilindo punonjës, i cili në ditën e fillimit të efekteve të ligjit në fjalë ka qenë në marrëdhënie pune në pozicione pjesë të shërbimit civil. Kjo prezumon verifikimin me imtësi të gjithë historikut të lindjes dhe zhvillimit të marrëdhënies së punës, si në ato institucione që përbënin shërbimin civil ekzistues, ashtu dhe marrëdhëniet e punës për ato institucione që u futën për herë të parë në shërbimin civil.

*
* *

Gjithë sa u parashtrua më sipër është gjendja faktike e menaxhimit të shërbimit civil, konstatuar nga grupi i inspektimit gjatë ushtrimit të funksionit të tij të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e ligjit gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në aspektin e deklarimit të statusit të punonjësve dhe nëpunësve aktualë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas pikës 1, 2 dhe 3 të këtij Raporti, janë materializuar në tabelën: **Aneksi nr. 1** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” me emërim të përkohshëm (data 26.02.2014)”, **Aneksi nr.2** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, me emërim të përkohshëm (data 26.02.2014)” dhe **Aneksi nr.3** “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA